



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 1421/1 Prot.

Tiranë, më 19 . 08 . 2026

V E N D I M

Nr. 225 , datë 19 . 08 . 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 176 Regj., datë 21.07.2026², të shtetasit B. D, kundër Bashkisë Lezhë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar³”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar pranë Komisionerit, rezulton se z. B. D ka ndjekur praktikën profesionale pranë Bashkisë Lezhë, në pozicionin Specialist, atashuar në Sektorin e të Ardhurave Vendore, për periudhën 23.09.2019–23.03.2020. Në përfundim të praktikës, ai është pajisur me Raportin e Vlerësimit, në të cilin është vlerësuar pozitivisht për pjesëmarrjen, njohuritë profesionale dhe aftësinë individuale për ushtrimin e profesionit.

Ankuesi shprehet se, gjatë kësaj periudhe, pranë Bashkisë Lezhë kishte vende vakante pune dhe, me qëllim punësimin e tij, i është kërkuar të paraqiste dokumentacionin përkatës. Megjithatë, procedura nuk është përmbyllur me punësimin e tij dhe ai nuk ka marrë asnjë shpjegim lidhur me mosfinalizimin e saj.

Pas përfundimit të praktikës profesionale, z. D është punësuar në sektorin privat, ku ka punuar për rreth tre vjet, duke fituar përvojë profesionale.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Plotësuar nga ankuesi nëpërmjet e-mailit datë 24.07.2026.

³ Ankuesi është posedues i Librezës së Përfituesit të Statusit të Invalidit Paraplegjik-Tetraplegjik, nr. 16873, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

⁴ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Më datë 16.09.2025, ai i është drejtuar Bashkisë Lezhë me një kërkesë për t'u marrë në konsideratë për punësim, në përputhje me arsimin, përvojën dhe aftësitë e tij profesionale, por pretendon se nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Ankuesi deklaron se është person me aftësi të kufizuar, paraplegjik dhe përdor karrocë lëvizëse, por thekson se kjo gjendje nuk e pengon të ushtrojë detyra administrative apo punë të tjera të përshtatshme në ambient zyre.

Sipas ankuesit, mospranimi në punë pas përfundimit me sukses të praktikës profesionale, pavarësisht ekzistencës së vendeve vakante, si edhe mungesa e përgjigjes ndaj kërkesës së tij për punësim, krijojnë bindjen se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë për shkak të aftësisë së kufizuar, në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit dhe detyrimet ligjore të institucioneve publike për garantimin e mundësive të barabarta në punësim.

Për sa më sipër, subjekti ankues i kërkon Komisionerit konstatimin e diskriminimit dhe rekomandimin ndaj Bashkisë Lezhë për shqyrtimin e kërkesës së tij për punësim.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar dhe për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it datë 21.07.2026, KMD, i ka kërkuar subjektit ankues të plotësojë dokumentacionin, apo të parashtojë fakte e prova lidhur me provueshmërinë e aplikimit të tij pranë strukturave përkatëse të Bashkisë, në një pozicion pune vakant në përputhje me arsimimin e tij.

Në përgjigje të kërkesës të mësipërme, ankuesi në e-mailin e dërguar më datë 24.07.2026, ka parashtruar sërish të njëjtat pretendime dhe shpjegime, pa depozituar asnjë shkresë apo provë të re. Ndër të tjera, në e-mailin e tij ankuesi citon se, *kërkesa që ka paraqitur pranë Bashkisë Lezhë ka qenë një kërkesë e përgjithshme për punësim dhe nuk i referohej një pozicioni konkret të shpallur vakant.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi.

Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë⁵.”*

⁵ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi respektivisht edhe për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

Në nenin 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstronhet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar pranë KMD-së, lidhur me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar nga ana e Bashkisë Lezhë, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Subjekti ankues ka pretenduar që është diskriminuar nga ana e Bashkisë Lezhë, duke mos u emëruar në një pozicion të përshtatshëm pune, në përputhje me nivelin e tij arsimor, për shkak të aftësisë së kufizuar të tij, por nuk ka depozituar asnjë dokument apo provë tjetër pranë KMD-së, që të provojë minimalisht se ka aplikuar për një pozicion konkret, specifik pune. Madje nuk ka identifikuar as që të ishin shpallur vende, pozicione pune vakante pranë kësaj Bashkie.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, ankuesi, për të mbështetur pretendimin e tij për emërimin në një pozicion pune në përputhje me nivelin e tij arsimor, do të duhej që fillimisht të provonte që ka aplikuar për një pozicion konkret, specifik.

Nëse, pas paraqitjes së kërkesës së tij/aplikimit për këtë pozicion të hamendësuar pune, ai nuk kualifikohet dhe pretendon se diskriminohet për cilindo shkak të parashikuar në LMD, ai ka të drejtën e ankimimit pranë Komisionerit.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk ka provuar pretendimet për diferencë në trajtim ose për dështimin nga ana e Bashkisë Lezhë, për të trajtuar rastin e tij, për shkak të situatës në të cilën ai gjendet, situatë e cila supozohet se ka si shkak aftësinë e kufizuar.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkakun sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këtë shkak, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkakun e pretenduar, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

- *Lidhur me pretendimin për diskriminim për periudhën pas përfundimit të praktikën profesionale pranë Bashkisë Lezhë, për periudhën 23.09.2019–23.03.2020*

Referuar informacionit të cituar në ankesë, z. D pretendon për diskriminim lidhur me mospunësimin e tij, në mujin mars 2020, periudhë kur ankuesi ka përfunduar praktikën profesionale dhe shprehet se ka aplikuar për punësim pranë Bashkisë.

Duke qenë se data e depozitimit të ankesës nr. 176 Regj., pranë KMD-së është 21.07.2026, rezulton se nga momenti i marrjes dijeni për sjelljen diskriminuese të pretenduar e deri në datën e paraqitjes së ankesës kanë kaluar më shumë se 6 (gjashtë) vjet.

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili parashikon se: “Ankesa nuk pranohet kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri gjykon se ankesa është paraqitur në tejkalim të afatit ligjor të parashikuar në LMD. Në afatet e parashikuara në këtë dispozitë janë alternative dhe jo kumulative; për mospranimin e ankesës mjafton plotësimi i njërit prej tyre.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ankesa është paraqitur tej afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për paraqitjen e ankesave pranë Komisionerit. Për rrjedhojë, ankesa nuk mund të pranohet për shqyrtim nga Komisioneri⁶.

- *Lidhur me pretendimin për diskriminim në kuadër të kërkesës së datës 16.09.2025*

Subjekti ankues nuk parashtroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucionit përgjegjës që të jenë motivuar nga shkak i pretenduar, pasi fillimisht ai duhet të plotësonte kërkesën minimale lidhur me provueshmërinë e paraqitjes së kërkesës ose aplikimit të tij për një pozicion konkret vakant, pranë strukturave përkatëse të Bashkisë Lezhë.

⁶ Për analogji shih vendimet nr. 64, datë 27.04.2023, nr. 139, datë 26.07.2023, nr. 161, datë 09.06.2026, të Komisionerit.

Në rastin konkret, ankuesi nuk identifikoi se kishte:

- një pozicion konkret për të cilin ka aplikuar;
- një procedurë konkrete rekrutimi;
- një shpallje konkrete;
- një vendim për skualifikimin/refuzimin e tij;
- një kandidat tjetër që është zgjedhur në vend të tij apo ndonjë person krahasues pa aftësi të kufizuara që ka qenë në të njëjtën situatë dhe është trajtuar ndryshe;
- kriteret mbi të cilat është bërë një përzgjedhje.

Komisioneri vëren se, punësimi në administratën publike, në varësi të pozicionit, kërkon respektimin e procedurave përkatëse të rekrutimit, kriterëve, konkurimit dhe kushteve të pozicionit. Prandaj, mosrealizimi i një pritshmërie për punësim nuk përbën në vetvete diskriminim. Kjo edhe për shkak se pretendimi faktik nuk është i barabartë me provën e faktit. Z. D pohon se *kërkesa që ka paraqitur pranë Bashkisë Lezhë ka qenë një kërkesë e përgjithshme për punësim dhe nuk i referohej një pozicioni konkret të shpallur vakant.*

Vetëm pasi ankuesi të provonte para KMD-së se ka paraqitur kërkesë apo aplikim për një pozicion konkret pune, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e Bashkisë Lezhë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁷.

- *Lidhur me pretendimin për moskthimin e përgjigjes nga Bashkia Lezhë,* ky kërkim i z. D nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj nga KMD, pasi Komisioneri vëren se, ky kërkim i ankuesit ka të bëjë me moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

Për rrjedhojë, ankuesi mund t’i drejtohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi hetimi sa më sipër nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së⁸. Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga LMD për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, pika 4/ç dhe “dh”, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁷ Për analogji shih vendimin nr. 187, datë 09.07.2026, të KMD-së.

⁸ Për analogji shih vendimet: nr. 167, datë 22.08.2022, nr.175, datë 05.08.2025 dhe nr. 41, datë 24.02.2026, të KMD-së.

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues B. D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)